
Konkurs për vende të lira pune

Caritas Kosova, në kuadër të projektit “E drejta ime” – Edukimi Gjithpërfshirës në Kosovë në bashkëpunim me Komunën e Prizrenit, shpall konkurs për vende të lira të punës në Prizren për pozitat:
8 (tetë) Psikolog/e - Asistent/e për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore

Prapavija:

Projekti “**My Right**” Edukimi Gjithpërfshirës në Kosovë, implementohet nga Caritas Kosova në partneritet me Komunën e Prizrenit respektivisht Drejtorinë Komunale të Arsimit. Projekti në fjalë financohet nga Agjensioni Austriak për Zhvillim dhe Caritas Austria.

Objektivi i përgjithshëm:

Qëllimi kryesor i projektit është ofrimi i shërbimeve cilësore për fëmijët me nevoja të veçanta në Qendrën e Edukimit të Hershëm si dhe në promovimin e Arsimit Gjithpërfshirës përmes procesit të transformimit të shkollave të rregullta në shkolla gjithpërfshirëse me theks të veçantë në të drejtat e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

Objektivat Specifike:

Ofrimi i arsimit cilësor, përmes krijimit të shkollave gjithpërfshirëse.

Pozita e punës:

Caritas Kosova në kuadër të projektit “E drejta ime” - Edukimi Gjithpërfshirës në Kosovë hap konkurs për 8 (tetë) pozita: Psikolog/e - Asistent/e për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. Këto pozita pune janë përzierje e detyrave të psikologut/es dhe asistentit/es për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore të përshkruara si më poshtë, të cilat janë kërkuar bazuar në projektin në fjalë dhe kërkesën e institucioneve arsimore të nivelit lokal në Komunën e Prizrenit.

Detyrat:

- Bashkëpunon me pedagogun e shkollës në të gjitha çështjet e përbashkëta të këtyre dy profesioneve;
 - Kontribuon në lehtësimin e procesit të të nxënës dhe promovon zhvillimin kognitiv, emocional, social dhe personal të nxënës;
 - Ofron ndihmë në tejkalimin e vështirësive të natyrës psikologjike me të gjithë akterët në shkollë;
 - Punon me nxënës për të zhvilluar strategji efektive të të nxënës, zhvillimit social e personal të nxënës;
 - Bashkëpunon me mësimdhënës, prindër dhe komunitetin;
-

- Ofron konsultime me mësimdhënës, prindër dhe komunitetin me qëllim të shëndetit sa më të mirë të nxënësve;
- Bashkëpunon me institucione profesionale të shkollës, institucione të tjera sociale dhe shëndetësore dhe organizata të tjera me qëllim të përvetësimit të praktikave të mira;
- Ndhmon fëmijët/nxënësit në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientim dhe mobilitet, transport, pozitën dhe uljen e nxënësit në klasë;
- Bashkëpunon me mësimdhënësit dhe stafin tjetër për zbatimin e PIA-së, lëndë të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve;
- Përgatit materiale mësimore si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës;
- Vëzhgon dhe dokumenton vështirësitë dhe nevojat e identifikuar të fëmijëve, përgatit informata kthyesë për vështirësitë dhe arritjet e fëmijëve;
- Promovon arsimin gjithëpërfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve me nevoja të veçanta në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim, për pjesëmarrje në lojë dhe stimulimin e të folurit dhe gjuhës përmes bisedës dhe lojës;
- Promovon bashkëpunimin shkollë-shtëpi, mbështet dhe diskuton çështje të ndjeshme me prindin/kujdestarin;
- Prezanton punën dhe arritjet e nxënësve dhe informacionet rreth tyre i trajton si plotësisht konfidenciale;
- Përdor pajisje specifike audio-vizuele teknologjike për të ndihmuar procesin e të nxënit;
- Paraqet punën dhe arritjet e nxënësve, plotëson dosjet/portfoliot e nxënësve;
- Bashkëpunon me personat profesional në shkollë/institucion si: pedagog, psikolog, etj.

Kriteret, kualifikimet, eksperiencia:

- Përgatitja e duhur akademike në fushën e psikologjisë dhe/ose edukimit inkluziv;
- Përvoja e dëshmuar profesionale në fushën e psikologjisë dhe/ose edukimit inkluziv;
- Përparësi do të kenë kandidatët me nivelin e edukimit master në fushën e psikologjisë shkollë.

Kandidatët e interesuar duhen të paraqesin për apikim dokumentet si vijon:

- Diploma dhe certifikata të tjera relevante;
- Letër motivuese;
- CV personale.

Metoda dhe afati i fundit për aplikim:

Kandidatët e interesuar duhet të aplikojnë më së largu deri më datë 27.10.2023 duke dërguar dokumentet e kërkuara në email adresën: info@caritaskosova.org. Subjekti në email me rastin e aplikimit duhet të jetë si vijon: **Aplikacioni_MyRight**.